



Prishtinë: 18.09.2008

Kodi i ZRRE-së: V\_122\_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_105\_09\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_105\_09\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Agim Humolli “Hotel Baci” (shifra e konsumatorit DPR – 90023571) në Prishtinë për arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi.

### Arsyetim

Konsumatori me datë 24.06.2008 ka parashtruar ankesës në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator të KEK-ut të datës 13.06.2008 për ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

- Me datë 22.05.2007 ekipi i kontrollës së KEK Sh.A kanë kontrolluar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë shprehur dyshimin se blloibat shtetërore janë të dyshimta.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 017403

- Me datë 21.11.2007 ekipi i kontrollës së KEK-ut ka bërë kontrollimin e pikës matëse të konsumatorit dhe ka shënuar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe prapë ka shpreh dyshimin për blloibat shtetërore.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 022947

- Me datë 21.03.2008 është bërë ndërrimi i grupit matës të konsumatorit dhe i njëjti është dërguar në Departamentin për kalibrim.

**Provë:** Procesverbali i KE-ut nr. 1576



- Me datë 23.03.2008 Departamenti për Matjen e Energjisë Elektrike – Qendra e Kalibrimit e Divizionit të Rrjetit ka kontrolluar njehsorin nr. 8050734 që i ka takuar konsumatorit me shifër DPR – 90023571, me rastin e kontrollimit është konstatuar se njehsori bllobat shtetërore i ka të manipuluar dhe ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror.  
**Provë:** Procesverbali i kalibrimit nr. 31/25 i datës 25.03.2008

- Me datë 22.05.2008 ekipi i kontrollit të KEK-ut ka bërë incizimin e seksionit të kabllit furnizues të konsumatorit dhe të elementeve tjera lidhëse të konsumatorit.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0141245

- Me datë 27.05.2008 Divizioni i Furnizimit të KEK-ut duke u bazuar në procesin nr. 0141245 dhe duke zbatuar Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike bënë llogaritjen e energjisë që konsumatori e ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar.

**Provë:** Fatura nr. 683

- Me datë 30.05.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, të faturuar në faturën e KEK-ut DPR08HP05857.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 13.06.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e parashtruar me 30.05.2008.

**Provë:** Përgjigja e KE-ut e datës 13.06.2008

DMK ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori, dhe ka gjetur se:

- KEK Sh.A në përgjigjen dhënë konsumatorit ka dobësi, por nuk ka bërë ndonjë shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore rregullative në fuqi.
- KEK Sh.A ka respektuar Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, me rastin e përpilimit të këtyre proceseve:
  - a) procesi i kontrollës Nr. 0141245 me të cilin është bërë incizimi i pikës matëse të konsumatorit
  - b) procesi i kalibrimit nr. 31/25
  - c) Fatura e llogaritjes së energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar nr. 683
- KEK-u nuk ka ndërmarrë veprim për ndërrimin e pikës matëse të konsumatorit pas shprehjes së dyshimit nga ekipi i kontrollës me datë 22.05.2007.



- Ekipi i kontrollës së KEK-ut në procesin Nr. 022947 të datës 21.11.2007 ka konstatuar se mbi bllobbën shtetërore është vendosur bllobba distributive, që nënkupton se pas datës 22.05.2007 ndonjë ekip i KEK-ut ka vendosur këtë bllobbë, por nuk ka bërë ndonjë proces.
- Konsumi i energjisë për muajin 4,5,6, 7 të vitit 2007 të regjistruar në njehsorin e vjetër ka qenë **35.184 kWh**, kurse konsumi i energjisë i regjistruar në njehsorin e ri për muajin 4,5,6,7 të vitit 2008 ka qenë **73.944 kWh**. Ky krahasim tregon se njehsori i vjetër ka regjistruar vetëm gjysmën e energjisë së konsumuar të këtij konsumatori.

Bazuar në këto të gjetura dhe në dëshmitë e paraqitura më lartë, DMK i Rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **refuzon ankesën** e konsumatorit për arsye se:

- KEK sh.a. ka ofruar dëshmi se konsumatori ka bërë korruptimin e njehsorit andaj ka bërë shkelje sipas Nenit 5.2 a) Të Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së. Mirëpo për shkak të lëshimeve në zbatimin e Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të përcaktuar në Nenin 12 c); KEK-u është i obliguar që të bëjë:

1. Rillogaritjen e energjisë së konsumuar nga data 21.03.2008, data e heqjes së njehsorit të abuzuar, duke u kthyer mbrapa deri me datën 22.05.2007, kur ekipi i kontrollit të KEK-ut ka shpreh dyshimin për abuzim të pikës matëse.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Nysret Avdiu, anëtar